

Shërbimi
i Shtetit
Planor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2026

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 78, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim **projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar.**

Ju faleminderit.

DEPUTETI PROPOZUES

Faust A. Balla
[Signature]



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. __, datë __. __. 2026

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 93/2015
“PËR TURIZMIN”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim deputeti,

V E N D O S I:

Në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në fund të nenit 28 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, Këshilli i Ministrave mund të vendosë ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të zonës me përparësi zhvillimin e turizmit për realizimin e projekteve ose investimeve me interes publik ose me rëndësi kombëtare që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Neni 2

Pas nenit 30, shtohet neni 30/a me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“

Neni 30/a

1. Këshilli i Ministrave mund të urdhërojë pezullimin e punimeve të ndërtimit në zonat turistike gjatë sezonit turistik, për të garantuar zhvillimin e qetë të tij. I njëjti rregull vlen edhe për aktivitetet e tjera të lidhura me punimet e ndërtimi, në rast se ato zhvillohen në këtë brez dhe ndikojnë në sezonin turistik. Vendimi i Këshillit të Ministrave për pezullimin sipas këtij neni përmban:

- i. Zonat konkrete që i nënshtrohen pezullimit, të cilat përcaktohen për secilën bashki;
- ii. Llojet e punimeve dhe aktiviteteve që i nënshtrohen pezullimit;
- iii. kohën e fillimit dhe të përfundimit të pezullimit sezonal, duke marrë në konsideratë të dhënat ose përvojën e viteve të mëparshme, apo pritshmërinë mbi fluksin e turistëve sipas muajve.;
- iv. mënyrën e zbatimit të pezullimit, i cili mund të zbatohet në mënyrë të përgjithshme gjatë periudhës së përcaktuar sipas nënparagrafit “iii”, ose duke ndaluar punimet përgjatë orareve të caktuara.

2. Periudha e pezullimit sipas këtij neni mbahet parasysh në përcaktimin e afatit total të punimeve për secilën leje ndërtimi, apo ushtrimi aktiviteti, që jepet në favor të subjekteve.

Neni 3

Neni 43 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 43/1 “Kategorizimi i strukturave akomoduese”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“Çdo subjekt zhvillues, përpara miratimit të lejes të ndërtimit për strukturë akomoduese nga organi përgjegjës, duhet të pajiset me një certifikatë paraprake kategorizimi sipas kriterëve të përcaktuara në zbatim të pikës 6 të këtij neni“.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kategoritë e strukturave akomoduese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. »

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon :

« Çdo strukturë akomoduese, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ka detyrimin të kryejë regjistrimin elektronik të klientëve, për qëllime të administrimit të veprimtarisë turistike, hartimit të statistikave zyrtare dhe përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj, me të dhënat për numrin e vizitorëve, netët e qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën. Përpunimi, ruajtja, transmetimi dhe mbrojtja e këtyre të dhënave kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. »

Neni 5

Në nenin 45 “Klasifikimi i strukturave akomoduese”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Çdo sipërmarrje turistike, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 6

Në nenin 64, pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtjen si vijon:

3/1. “*Subjekti që ushtron veprimtarinë stacion plazhi duhet të garantojë aksesin e lirë, të pandërprerë dhe lëvizjen e lirë të publikut drejt bregut të detit, përgjatë vijës bregdetare dhe ndërmjet hapësirave publike të plazhit. Ndalohet vendosja e gardheve, mureve, barrierave apo e çdo pengese tjetër fizike, të përherëshme ose të përkohshme, që kufizon ose pengon këtë akses dhe lëvizje*”.

Neni 7

Në nenin 71, pas shkronjës “s”, shtohen shkronjat “sh” dhe “t” me përmbajtje si vijon:

“sh) moszbatimi i kriterëve sipas përcaktimeve të nenit 30/1, dënohet me gjobë 2,000,000 lekë;

t) mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në nenin 64, në pikën 3/1 dënohet me gjobë 200,000 lekë”.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Për lejet e ndërtimit, ose të aktiviteteve të tjera, të dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë dhe KKTU, ose autoritetet e tjera kompetente për dhënien e lejeve të shfrytëzimit për aktivitetet e tjera të lidhura, janë të detyruara që, në rast pezullimi sipas nenit 30/a të ligjit nr. 93/2015 të ndryshuar, me kërkesë të subjekteve zhvilluese, të miratojnë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve/aktiviteteve, duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e pezullimit të miratuar.

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

NIKO PELESHI

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.93/2015, “PËR TURIZMIN”, TË NDRYSHUAR”

QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon krijimin e bazës ligjore të nevojshme për pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe të aktiviteteve të lidhura me to, përgjatë sezonit turistik dhe që ndikojnë në të, me qëllim garantimin e zhvillimit të qetë të këtij sezoni dhe cilësinë sa më të lartë të ofertës turistike të vendit tonë.

Ai synon gjithashtu rregullimin e procesit të kategorizimit dhe klasifikimit të strukturave akomoduese, duke e zhvendosur përcaktimin e kategorive dhe kriterëve nga niveli i ligjit në aktet nënligjore, si dhe duke futur instrumentin e certifikatës paraprake të kategorizimit si kusht paraprak për pajisjen me leje ndërtimi për strukturat akomoduese.

Objektivat kryesorë janë:

- Sigurimi i një kuadri fleksibël dhe të përditësueshëm të kategorive të strukturave akomoduese, në përputhje me zhvillimet e tregut turistik dhe standardet ndërkombëtare;
- Ndërhyrja në fazën e projektimit dhe të lejes së ndërtimit, në mënyrë që struktura akomoduese të ndërtohet që në fillim sipas standardeve të kategorisë së synuar, duke shmangur ndërhyrjet korrigjuese pas përfundimit të investimit;
- Thjeshtimi dhe unifikimi i procedurës së kategorizimit dhe klasifikimit pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin;
- Forcimi i detyrimeve të strukturave akomoduese për regjistrimin elektronik të klientëve dhe menaxhimin e mbetjeve;
- Përmirësimi i cilësisë së të dhënave statistikore turistike nëpërmjet Regjistrat Qendror të Turizmit.

VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT

Projektligji nuk bie ndesh me acquis-në e Bashkimit Evropian dhe mbështet përafrimin me praktikat e vendeve anëtare në fushën e standardizimit të shërbimeve akomoduese.

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me legjislacionin në fuqi, përfshirë ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT

Sektori i turizmit përfaqëson një nga sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare dhe ka marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Rritja e numrit të turistëve, zgjerimi i investimeve në struktura akomoduese dhe nevoja për administrim më efikas të zonave turistike kanë evidentuar nevojën për:

- garantimin e cilësisë së investimeve turistike që në fazën e planifikimit;
- shmangien e ndikimeve negative të veprimtarive ndërtimore gjatë sezonit turistik;
- qartësimin e procedurave të kategorizimit dhe klasifikimit të strukturave akomoduese;
- mbrojtjen e aksesit publik në plazhe dhe në vijën bregdetare;
- forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe të masave administrative ndaj shkeljeve.

Përvoja e viteve të fundit ka treguar se zhvillimi i punimeve të ndërtimit në periudhën e sezonit turistik krijon ndikime negative mbi mjedisin turistik, sigurinë, qarkullimin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara turistëve, duke cenuar imazhin e destinacioneve turistike.

Nga ana tjetër, është konstatuar nevoja për një mekanizëm paraprak të kontrollit të strukturave akomoduese, me qëllim garantimin që investimet e reja të ndërtohen sipas kategorisë turistike që synojnë të përfaqësojnë.

Përparësia e këtij projektakti paraqitet në dy drejtime si më poshtë:

- Së pari, në garantimin e zhvillimit në mënyrë sa më të qetë dhe pa eksternalitete dëmtuese, të sezonit turistik. Norma autorizuese e pezullimit që propozohet të shtohet përmes nenit 1 të projektligjit, si nen 30/a i ligjit “Për turizmin” përbën një instrument për të mundësuar një standard sa më të mirë në ecurinë e sezonit turistik në vend. Kjo duke marrë duke patur një qasje që bazohet në përligjje të arsyeshme dhe që respekton parimin e proporcionalitetit.

Për sa i përket përligjjes së arsyeshme, sqarojmë se ajo konsiston pikërisht në garandimin e një cilësie sa më të lartë të shërbimit turistik që ofrohet në vend dhe një eksperiencë sa më të mirë turistike për pushuesit në tërësi dhe veçanërisht për turistët e huaj, duke qenë se ofrimi i një shërbimi turistik sa më të kënaqshëm për këta të fundit (turistët e huaj), është premisë e domosdoshme për rritjen e vetë ekonomisë turistike të vendit. Në këtë linjë, punimet e ndërtimit, edhe pse përbëjnë një drejtim gjithashtu të rëndësishëm për zhvillimin urban dhe ekonomik të vendit, është evidente se shkaktojnë “shqetësim” të eksperincës turistike për pushuesit për shkak të karakterit invaziv që ato kanë dhe të ndotjes edhe akustike që ato passjellin. Është një fakt i gjithëditur se veprimtaria ndërtimore dhe veprimtaritë e lidhura me të (siç mund të jenë përshebull gërmimet, etj.), interferon negativisht gjatë sezonit turistik, në zonat turistike. Për këtë arsye, duke bërë balancën ndërmjet të drejtave dhe interesave të ligjshme të përfshira, vlerësojmë se do të ishte e arsyeshme që kjo veprimtari ndërtimore të pezullohej gjatë sezonit turistik, në funksion të interesit publik që konsiston në zhvillimin turistik të vendit.

Për sa i përket proporcionalitetit, ai evidentohet së pari në faktin se në dispozitën e propozuar pezullimi konceptohet si një masë e kufizuar si në kohë ashtu edhe në hapësirë dhe nga pikëpamja substanciale, jo si një ndalim absolut dhe i gjithëkohshëm. Ai madje nuk është e thënë që të shtrihet as përgjatë gjithë sezonit turistik, por mund të qëndrojë vetëm përgjatë një pjese të tij dhe madje edhe vetëm për intervale orare të caktuara të ditës, sikurse përcaktohet nga dispozita. Kjo përpos faktit se pezullimi do të zbatohet vetëm për ato veprimtari që ndikojnë në ecurinë turistike dhe vetëm në zonat përkatëse. Për më tepër garancia e rëndësishme për respektimin e proporcionalitetit, është fakti se neni 30/a i propozuar e njeh të drejtën e subjekteve ndërtuese dhe të subjekteve të tjera që kryejnë veprimtaritë e lidhura me to, që afatit pezullimit tu njihet për efekt të përcaktimit të afatit të përfundimit të punimeve/aktiviteteve në lejen përkatëse.

Pra që ky afat i përfundimit të punimeve të caktohet duke marrë parasysh edhe kohën e humbur prej tyre për shkak të pezullimit, në mënyrë që pezullimi të mos

shkaktojë cenim substantial të të drejtave të tyre. I njëjti parim është ndjekur edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij projektligji, sikurse është përcaktuar në dispozitën kalimtare të tij (neni 5).

●Së dyti , përparësia në miratimin e projektligjit qëndron në garantimin e fleksibilitetit të nevojshëm normative në përcaktimin e kategorive akomoduese, klasifikimin e tyre, në përputhje me shembujt e shumicës së vendeve evropiane, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë dhe të seriozitetit të nismave të subjekteve për ngritjen e strukturave të tilla.

Sqarojmë se ligji nr. 93/2015 i ndryshuar, ndryshe nga modelet e shumicës së vendeve evropiane I përmban listat shtrruese të kategorive dhe të klasifikimeve në vetë tekstin e tij. Ndërkohë që ndryshimet e tregut dhe të veprimtarive turistike, kërkojnë që këto aspekte, që në të vërtetë janë të natyrës më tepër teknike sesa substanciale (pra nuk kanë të bëjnë me thelbin dhe parimet e ligjit, por me instrumenta zbatues të derivuar të tyre) të përcaktohen përmes akteve nënligjore. KJo duke garantuar në këtë mënyrë që strukturat shtetërore të përgjigjen në mënyrë të shpejtë dhe efektive ndaj dinamikave të zhvillimit dhe nevojave turistike. Në këtë prizëm është tërësisht joefektive dhe e pajustificuar që aspekte të tilla teknike siç i përmendëm, të kërkojnë ndërmarrjen e iniciativës ligjvënëse, ndërkohë që pushteti ekzekutiv duhet të ketë mundësinë që tu përgjigjet këtyre ekzigjencave teknike-konkrete përmes akteve nënligjore.

Po tu referohemi modeleve evropiane, tendenca dominuese është që:

- **Ligji** të përcaktojë kuadrin bazë: çfarë konsiderohet strukturë turistike, kush është organi kompetent, autorizimin për klasifikim/kategorizim, efektet juridike të certifikimit.
- **Akti nënligjor** (rregullore, dekret, urdhër ministror) përcakton kategoritë konkrete, klasat, yjet, kriteret teknike, shenjat dalluese dhe procedurat e detajuara.

Pra, modeli shqiptar pas ndryshimeve të vitit 2024 (ku vetë ligji liston të gjitha kategoritë) është më I ngurtësues shumë vende evropiane.

Si shembuj të vendeve të tjera paraqesim:

Kroacia

Ligji kroat përmban vetëm autorizimet ligjore, ndërsa kategorizimi dhe klasifikimi konkret bëhen me **rregullore ministrore (Pravilnik)**. Në këto rregullore përcaktohen:

- llojet e objekteve;
- kategoritë;
- yjet;
- standardet;
- mënyra e shënimit të kategorisë. [\[zakon.hr\]](#), [\[gov.hr\]](#)

Madje ekzistojnë rregullore të veçanta për:

- hotelet;
- kampingjet;
- apartamentet;
- akomodimin familjar. [\[zakon.hr\]](#), [\[en.hrturizam.hr\]](#)

Kjo do të thotë modelin kroat këto çështje gjenden të normuara në rregullore, jo në ligj.

Greqia

Edhe Greqia përdor një model të ngjashëm.

Ligji nr. 4276/2014 krijon autorizimin normativ për detajimin e çështjeve të kësaj natyre.

Dhe rrejdhimisht:

- klasifikimi i hoteleve me yje;
- kriteret teknike;
- kriteret e pikëzimit;
- kalimi nga një kategori në tjetrën

janë vendosur me **Vendimin Ministror nr. 216/2015** (“Determination of technical and operational specifications and graded criteria for hotels and classification into star categories”). [\[e-nomothesia.gr\]](http://e-nomothesia.gr), [\[elinyae.gr\]](http://elinyae.gr)

Franca

Kodi i Turizmit përmban autorizimet ligjore.

Dhe:

- skema e klasifikimit 1–5 yje;
- kriteret e klasifikimit;
- procedurat e inspektimit;
- standardet për secilën kategori

janë përcaktuar me **Arrêté du 29 décembre 2021**, pra me një akt me karakter normativ të nivelit nënligjor. [\[legifrance.gouv.fr\]](http://legifrance.gouv.fr), [\[legifrance.gouv.fr\]](http://legifrance.gouv.fr)

Gjermania / Hotelstars Union

Modeli gjerman është edhe më larg modelit aktual shqiptar.

- ligji nuk numëron kategoritë e detajuara;
- sistemi i yjeve (klasifikimit) përcaktohet nga skema Hotelstars Union;
- kriteret janë në kataloge teknike dhe rregulla të klasifikimit, jo në ligj. [\[hotelstars.eu\]](http://hotelstars.eu), [\[hotelstars.eu\]](http://hotelstars.eu)

Pra, kategorizimi dhe klasifikimi janë kryesisht çështje rregullatore dhe teknike, të nivelit nënligjor.

Sikurse dallohet qartë, në të gjitha këto vende europiane, shtimi i një kategorie të re, apo klasifikimi të ri mund të bëhet duke ndryshuar rregulloren përkatëse, pa pasur nevojë të ndryshohet ligji. Kjo është pikërisht arsyeja pse shumë vende e delegojnë këtë çështje për rregullim në akt nënligjor.

Ky është pikërisht shembulli dhe modeli që I nevojitet edhe vendit tonë, në kuadër të lehtësimit të procedurave në fushën e turizmit.

VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË,

Projekt-akti është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi të saj.

VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektligji nuk synon përafrim me acquis communautaire.

PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 9 nene, si më poshtë:

Neni 1

Në fund të nenit 28 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, Këshilli i Ministrave mund të vendosë ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të zonës me përparësi zhvillimin e turizmit për realizimin e projekteve ose investimeve me interes publik ose me rëndësi kombëtare që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Neni 2

Pas nenit 30, shtohet neni 30/a me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“

Neni 30/a

1. Këshilli i Ministrave mund të urdhërojë pezullimin e punimeve të ndërtimit në zonat turistike gjatë sezonit turistik, për të garantuar zhvillimin e qetë të tij. I njëjti rregull vlen edhe për aktivitetet e tjera të lidhura me punimet e ndërtimi, në rast se ato zhvillohen në këtë brez dhe ndikojnë në sezonin turistik. Vendimi i Këshillit të Ministrave për pezullimin sipas këtij neni përmban:

- i. Zonat konkrete që i nënshtrohen pezullimit, të cilat përcaktohen për secilën bashki;
- ii. Llojet e punimeve dhe aktiviteteve që i nënshtrohen pezullimit;
- iii. kohën e fillimit dhe të përfundimit të pezullimit sezonal, duke marrë në konsideratë të dhënat ose përvojën e viteve të mëparshme, apo pritshmërinë mbi fluksin e turistëve sipas muajve.;
- iv. mënyrën e zbatimit të pezullimit, i cili mund të zbatohet në mënyrë të përgjithshme gjatë periudhës së përcaktuar sipas nënparagrafit “iii”, ose duke ndaluar punimet përgjatë orareve të caktuara.

2. Periudha e pezullimit sipas këtij neni mbahet parasysh në përcaktimin e afatit total të punimeve për secilën leje ndërtimi, apo ushtrimi aktiviteti, që jepet në favor të subjekteve.

Neni 3

Neni 43 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 43/1 “Kategorizimi i strukturave akomoduese”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“Çdo subjekt zhvillues, përpara miratimit të lejes të ndërtimit për strukturë akomoduese nga organi përgjegjës, duhet të pajiset me një certifikatë paraprake kategorizimi sipas kriterëve të përcaktuara në zbatim të pikës 6 të këtij neni“.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kategoritë e strukturave akomoduese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. »

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon :

« Çdo strukturë akomoduese, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, ka detyrimin të kryejë regjistrimin elektronik të klientëve, për qëllime të administrimit të veprimtarisë turistike, hartimit të statistikave zyrtare dhe përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj, me të dhënat për numrin e vizitorëve, netët e qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën. Përpunimi, ruajtja, transmetimi dhe mbrojtja e këtyre të dhënave kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. »

Neni 5

Në nenin 45 “Klasifikimi i strukturave akomoduese”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Çdo sipërmarrje turistike, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 6

Në nenin 64, pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtjen si vijon:

3/1. “Subjekti që ushtron veprimtarinë stacion plazhi duhet të garantojë aksesin e lirë, të pandërprerë dhe lëvizjen e lirë të publikut drejt bregut të detit, përgjatë vijës bregdetare dhe ndërmjet hapësirave publike të plazhit. Ndalohet vendosja e gardheve, mureve, barrierave apo e çdo pengese tjetër fizike, të përhershme ose të përkohshme, që kufizon ose pengon këtë akses dhe lëvizje”.

Neni 7

Në nenin 71, pas shkronjës “s”, shtohen shkronjat “sh” dhe “t” me përmbajtje si vijon:

“sh) moszbatimi i kriterëve sipas përcaktimeve të nenit 30/1, dënohet me gjobë 2,000,000 lekë;

t) mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në nenin 64, në pikën 3/1 dënohet me gjobë 200,000 lekë”.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

Për lejet e ndërtimit, ose të aktiviteteve të tjera, të dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë dhe KKTU, ose autoritetet e tjera kompetente për dhënien e lejeve të shfrytëzimit për aktivitetet e tjera të lidhura, janë të detyruara që, në rast pezullimi sipas nenit 30/a të ligjit nr. 93/2015 të ndryshuar, me kërkesë të subjekteve zhvilluese, të miratojnë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve/aktiviteteve, duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e pezullimit të miratuar.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

- Ministria përgjegjëse për turizmin (kategorizimi, klasifikimi, Regjistri Qendror i Turizmit, rregullorja nënligjore);
- Këshilli i Ministrave (miratimi i vendimeve të pezullimit, dhe i vendimeve për kategoritë);
- Organet përgjegjëse për dhënien e lejeve të ndërtimit (verifikimi i certifikatës paraprake të kategorizimit);
- Qendra Kombëtare e Biznesit (regjistrimi i subjekteve);
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore (rregullat për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve).

EFEKTET FINANCIARE TË PROJEKTAKTIT

Zbatimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit. Projektligji ka vetëm efekt procedural.

AFATI I HYRJES NË FUQI

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.